

SHOQËRIA CIVILE ALARMON PËR SHKATËRRIM TROTUARESH

Kompanitë punëkryerëse dëmtojnë infrastrukturën publike

Arian Duriqi

LIPJAN, 22 KORRIK – Në qendrën e Lipjanit kohëve të fundit nuk po kursehen trotuaret nga kompani të ndryshme ndërtime, ndërsa në këtë plan ka ardhur edhe një alarm nga shoqëria civile e kësaj komune. Në të vërtetë, ka qenë OJQ Youth Association for Human Rights (YAHR) që thotë se ka identifikuar një fenomen në rritje që po ndodh në qytetin e Lipjanit.

Bekim Krasniqi, udhëheqës në YAHR, ka deklaruar se kjo dukuri po merr përmasa të gjëra.

“Fenomeni negativ që po ndodh në Lipjan ditëve të fundit është ai i shkatërrimit masiv të trotuareve për lëvizjen e këmbësoreve nëpër rrugët kryesore të qytetit dhe kjo po bëhet nga kompanitë e ndërtimit gjatë kycjeve të ndryshme në infrastrukturë. Me këtë rast po rrezikohen edhe këmbësorët gjatë lëvizjes së tyre nëpër qendër”, ka thënë ai. Mirëpo, Krasniqi, është shprehur i bindur se kësaj dukurie po i kontribuon edhe mosefikasiteti i drejtuesve të Inspektorisë në Lipjan, që sipas tij, nuk kanë marrë asnjë veprim në parandalimin e kësaj dukurie.

“Nga Drejtoria e Inspektorisë nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të parandaluar këtë fenomen në rritje që po ndodh nga kompani të ndryshme, të cilat po i shkatërrojnë trotuaret për lëvizje të këmbësorëve gjatë punimeve të objekteve të tyre”, ka thënë Krasniqi.

Ky ka edhe një propozim për autoritetet komunale.

“Organizata jonë i propozon ekzekutivit dhe legjislativit të komunës së Lipjanit që në kuadër të planifikimeve buxhetore për vitin



Bajram Rizani, drejtor i Inspektorisë së Lipjanit, ka thënë se të gjitha kompanitë që punojnë në qendër, qoftë ato të kontraktuara nga Komuna në rrjete ujësjellësish a kanalizimesh, qoftë të angazhuara nga bizneset për kycje të ndryshme, janë të obliguara që ta kthejnë trotuarin në gjendjen e mëparshme

2013 të planifikohen mjete buxhetore për të implementuar një projekt për rregullimin e të gjitha trotuareve me kubëza nëpër rrugët kryesore të qytetit të Lipjanit”, ka thënë ai.

Kurse, Bajram Rizani, drejtor në Inspektorinë e Lipjanit, ka thënë të dielën se të gjitha kompanitë që punojnë në qendër qoftë ato të kontraktuara nga Komuna në rrjete ujësjellësish e kanalizimesh, qoftë të angazhuara nga bizneset për kycje të ndryshme, janë të obliguara që ta kthejnë trotuarin në gjendjen siç ka qenë, apo ndryshe gjobiten. Ai ka deklaruar po ashtu se inspektorët që drejton janë shumë aktivë në nd-

jekje të të gjitha dukurive negative në Lipjan.

“Të gjitha kompanitë që dëmtojnë trotuaret janë të obliguara që ato t'i kthejnë në gjendjen e mëparshme. Dhe, në qoftë se trotuari nuk kthehet në gjendjen siç ka qenë pason fletëparaqitja për gjobë dhe këtu nuk do të falet askush”, ka thënë ai.

Rizani ka shtuar se do të ketë një analizë të veçantë të kësaj situatë për të gjithë ata që e kanë dëmtuar pasurinë publike.

“Ne jemi të përkushtuar të ndër marrim masa sipas rregullores e ligjeve që janë në fuqi dhe nuk lejojmë dëmtim të pasurisë publike”, ka thënë ai.

DRENAS
Këshilltar
municipal t
prezantim
vitin 201
interesat
e investit
këshilltar
kritikuar
së projek
thënë se
vendet k
nuk është
rrugë dhe
Arllat nu
përfshirë
jekteve p
se nuk është
këtë listë
investim.
është bërë
Sipas tij,
Shemsi I
fontanë d
jektet e k
po shfaq
këshilltar
ekzekutiv
tet e nisur
e madhe.

Në ko

DRENAS
Drejtoria
veta. Dre
shpallur k
asit. “Kor
shumë i n
dhe PROFE
të Punës
punëkërka
ka thënë
punëkërka
real të pa
në mbi 20
viti në vit
tarëve të
marrin 18

NIS DEZINFEKTIMI I HAPËSIRAVE PUBLIKE NË GJILAN

Dezinsektohet qyteti, fshatrat ar